



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:182633

Datë: 12.06.2024

Numri i dokumentit: 05812560

KA.nr.338/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Kolegji ISPE”, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Agjencia e Kosovës për Akreditim, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit Nr. Ref. 576/20D i datës 22.06.2020, i të paditurës Agjencia e Kosovës për Akreditim-Këshilli Shtetëror i Cilësisë dhe Vendimi Nr. KA.NR. 2909/20 i datës 23.11.2020, i Komisionit të Ankesave të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesorë publik të mbajtur me datë 05.03.2024 dhe me datë 17.04.2024, më 21.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit Kolegji ISPE me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Agjencia e Kosovës për Akreditim, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, me çka ka kërkuar anulimin e Vendimit Nr. Ref. 576/20D të datës 22.06.2020, të nxjerrë nga e paditura Agjencia e Kosovës për Akreditim, Këshilli Shtetëror i Cilësisë dhe Vendimit KA. Nr. 2909/20 i datës 23.11.2020, i Komisionit të Ankesave të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, me propozim që të obligohet Këshilli Shtetëror i Cilësisë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, që të nxjerr vendim me të cilin i aprovohet kërkesa Kolegjit ISPE për akreditim të programit të studimit, Studime të Sigurisë, BA 180 ECTS, si e pabazuar.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

## Historiku procedural

1. Me datë 22.12.2020, në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, paditësi Kolegji ISPE me seli në Prishtinë, ka parashtruar padi e evidentuar me nr. A.nr.2213/20, kundër të paditurës Agjencia e Kosovës për Akreditim, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, me kërkesë për anulim të Vendimit Nr. Ref. 576/20D të datës 22.06.2020, të nxjerrë nga e paditura Agjencia e Kosovës për Akreditim, Këshilli Shtetëror i Cilësisë dhe Vendimit KA. Nr. 2909/20 i datës 23.11.2020, i Komisionit të Ankesave të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, me propozim që të aprovohet padia e paditësit dhe të anulohet Vendimi me Nr. Ref 576/20D i datës 22.06.2020, i të paditurës dhe Vendimi Nr KA.Nr.2909/20 i datës 23.11.2020, i Komisionit të Ankesave të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, të obligohet Këshilli Shtetëror i Cilësisë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, që të nxjerr vendim me të cilin i aprovohet kërkesa Kolegjit ISPE për akreditim të programit të studimit, Studime të Sigurisë, BA 180 ECTS.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr. 338/22.
3. Gjykata më datë 14.02.2024 mbajti seancë përgatitore ndërsa më datë 05.03.2024 mbajti seancë të shqyrtimit kryesor me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit sipas autorizimit A.M. dhe të përfaqësuesit të palës së paditur Sadin Bytyqi sipas autorizimit të datës 01.02.2024 dhe më datë 17.04.2024, në mungesë të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, konform nenit 41 të LKA-së, i cili ka qenë i njoftuar për ditën dhe kohën e mbajtjes së seancës sipas procesverbalit të datës 04.04.2024, ndërsa me pjesëmarrje të përfaqësuesit të palës së paditur S.B..
4. Me date 17.04.2024 përfaqësuesi i paditësit ka parashtruar kërkesë për përjashtim te gjyqtares, e cila i është refuzuar me Aktvendim te Kryetarit te Gjykatës me nr.Gj.A.3570/24 te datës 21.05.2024.

## Pretendimet e paditësit

5. Përfaqësuesi i paditësit në pretendimet e tij në padi, gjatë seancës së shqyrtimit kryesorë publik të datës 05.03.2024 ka deklaruar se në bazë të vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC), të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) me Nr. Ref 576/20D të datës 22.06.2020, është refuzuar kërkesë për akreditimin e programit Studime të Sigurisë, BA 180 ECTS, me arsyetim se “Sipas nenit 30 të UA për Akreditim IAL-të duhet të dorëzojnë deklaratat e stafit akademik të angazhuar, jo më larg se data 31 Tetor. Njeri nga bartësit e këtij programi B.I. është deklaruar si staf i rregullt me orar të plotë në dy institucione të arsimit të lartë. Për O.S., pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar është konstatuar se mungon leje qëndrimi, kurse për A.M.1., është konstatuar se mungon deklarata nën betim. Ankesën kundër vendimit Komisioni i Ankesave e refuzon me Vendimin Nr.KA/Nr.2909/20 të datës 23.11.2020 me arsyetim se nga shqyrtimi i dosjeve ka rezultuar se: B.I. ishte i deklaruar si staf i rregullt me orar të plote në dy institucione të arsimit të lartë, e për çka, sipas Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, respektivisht nenit 30, paragrafin 2, i njëjti është larguar nga lista e bartësve të programit. Kjo dëshmohet edhe përmes platformës së e-akreditimit. O.S. i kishte munguar leje qëndrimi në Kosovë, si shtetase e huaj, e për të cilën Kolegji ISPE nuk kishte dorëzuar dokumentet plotësuese që dëshmojnë të kundërtën. A.M.1. i kishte munguar deklarata nën betim për vitin akademik 2019/2020. I njëjti deri me datën 31 tetor 2019, ka dorëzuar deklaratën nën betim, po e cila ka qenë e nënshkruar me date 16.04.2018.
6. Ka shtuar se vendimi i të paditurës si ai i shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë janë jo ligjore, sepse paditësi në tërësi ka plotësuar kriteret e kërkuara sipas dispozitave ligjore për akreditim. KSHC ka pasur vonesë në trajtimin e aplikacionit të Kolegjit për më shumë se 6 muaj nga data e mbylljes së afatit për aplikim (31 Tetor 2019) në mbledhjen e 80-të të datës 1 Prill 2020, është vendosur për aplikacionin e Kolegjit ISPE ndërsa deri në momentin e njoftimit të Kolegjit ISPE, për vendimin e marrë më datë 24 Qershor 2020, janë gati 3 muaj kohë. Me këtë veprim KSHC/AKA, jo që nuk ka përfillur rekomandimet e ekspertëve të jashtëm për vlerësim, por edhe ka shkaktuar dëme të pa riparueshme ndaj Kolegjit ISPE, KSHC ka marr kompetenca edhe të verifikimit të situatës faktike, por edhe të marrjes së vendimit, çka është në kundërshtim të plotë me parimin e ndarjes së kompetencave, të paraparë me UA 15/2018 të cilit i referohet vendimi. Në pikën I të arsyetimit të vendimit Nr. Ref 576/20D të datës 22.06.2020 thuhet se Kolegji ISPE për programin BA Studime të Sigurisë ka paraparë stafin akademik B.I., A.M., O.S., R.D.

dhe A.M.1.. Në po të njëjtën pikë par.3 thuhet se ky program ka 180 ECTS dhe rrjedhimisht sipas nenit 26 pika 5.3.4 e UA për Akreditim për këtë program të studimit të Kolegjit ISPE duhet të ketë të paktën 3 staf akademik me gradën shkencore PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit”. Në kohën e aplikimit në AKA më datë 31 Tetor 2019 Kolegji ISPE kishte jo 3 staf akademik sa kërkohen me UA për Akreditim 15/2018 të datës 28.09.2018, por kishte katër staf akademik me dosje komplete dhe adekuat për fushën e programit të studimit. Si rezultat i vonesave të trajtimit të aplikacionit të Kolegjit ISPE nga ana e AKA/KSHC njëri nga katër anëtarët e stafit të deklaruar nga Kolegji ISPE B.I., ishte deklaruar në ndërkohë për një institucion tjetër, kjo e deklaruar nga anëtarët e KSHC në takimin e mbajtur me qëllim të dhënies së afatit tjetër për IAL-të, për kompletimin e dosjeve për stafin e deklaruar, ku ishte vendosur që KSHC/AKA do të krijonin qasje në sistemin E-Akreditimi në mënyrë që Kolegji ISPE të bënte ndryshime e nevojshme në listën e stafit në ndërkohë. Stafi i mbetur ishte i mjaftueshëm sipas nenit 26 pika 5.3.4 të UA 15/2018 të datës 28.09.2018 me dosje të kompletuar A.M., R.D., A.M.1..

7. Për më tepër ka deklaruar se më datë 10 Prill 2020 AKA në faqen e saj zyrtare kishte paraqitur njoftimin e programeve të aprovuara, ku për Kolegjin ISPE në listë figuronte vetëm A.M. dhe R.D. si staf i pranuar nga AK-ja përderisa nuk figuronte A.M.1. edhe pse për të njëjtin ishte dërguar i gjithë dokumentacioni. Pas kërkesës së Kolegjit ISPE për sqarim drejtuar AKA-së, në përgjigje thuhej se ishte gabim teknik mos futja në listë e Z. M., por arsyeja pse ishte refuzuar programi pavarësisht se dosja ishte në rregull, është se në listën e E-Akreditimit figuronte edhe Z.B.I., ndërsa për A.M.1. ka munguar deklarata nën betim, ndërsa për dy anëtarët e stafit akademik nuk kontestohet dosja e tyre, është kontestimi mbetet vetëm për A.M.1., prandaj bordi i AKA-së unanimisht ka vendosur refuzimin e aplikimit të këtij programi. Ndërsa për situatën në lidhje me Z. B.I. ishte sqaruar plotësisht në takimin e datës 07.02.2020, ku Z.I. pas datës 31 Tetor 2019, ishte deklaruar për një institucion tjetër dhe AKA ishte pajtuar që Kolegjit ISPE ti krijonte qasje në E-Akreditim dhe ta largonin emrin e Z. I. nga lista edhe pse një qasje e tillë nuk ishte lejuar kur, pasi që qasja në sistem E-Akreditimi lejohet vetëm nga AK-ja. Kolegjit ISPE i është shkaktuar dëm si në kontekst akademik por edhe dëm të pariparueshëm financiar, i ka propozuar gjykatës që të aprovohet padia e paditësit dhe të anulohet Vendimi me Nr. Ref 576/20D i datës 22.06.2020, i të paditurës dhe Vendimi Nr. KA.Nr.2909/20 i datës 23.11.2020, i Komisionit të Ankesave të Agjencisë së

Kosovës për Akreditim. Të obligohet Këshilli Shtetëror i Cilësisë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, që të nxjerr vendim me të cilin i aprovohet kërkesa Kolegjit ISPE për akreditim të programit të studimit, Studime të Sigurisë, BA 180 ECTS.

### Kundërshtimet e të paditurës

8. Përfaqësuesi sipas autorizimit i palës së paditur në pretendimet e dhëna në përgjigje në padi, gjatë seancës së shqyrtimit kryesorë publik dhe në fjalën përfundimtare të dhënë më datë 08.04.2024 ka deklaruar se AKA e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit Kolegji ISPE si të pa bazuar, me arsyetim se paditësi nuk ka arritur me asnjë fakt të argumentoj pretendimet e tij. Sipas UA Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën re Kosovës në nenin 11 par.1 thuhet Agjencia për Akreditim ka kohë një vit për trajtimin e aplikacioneve prej datës së pranimit të kërkesës për akreditim. Prandaj pretendimi i paditësit nuk qëndron për faktin se organi vendimmarrës KSHC/AKA ka shqyrtuar dhe ka vendosur brenda afatit ligjor. Deklaron se nuk qëndrojnë pretendimet e paditësit se “i padituri jo që nuk ka përfillur rekomandimet e ekspertëve, por edhe ka shkaktuar dëme të pa riparueshme ndaj Kolegjit ISPE, marrë parasysh edhe afatet ligjore të përgjigjes në Ankesë nga organet respektive kompetente, KSHC/AKA nuk ka respektuar as rekomandimet e ekspertëve të ENQA-së për proceset e vlerësimit dhe akreditimit, duke mohuar të drejtën bazë të garantuar me Kushtetutë dhe ligjet respektive të subjekteve të së drejtës për trajtim të barabartë dhe në bazë të ligjit”, këto pretendime nuk qëndrojnë për faktin se paditësi në rast se vlerëson se ka pasur vonesë të organit vendimmarrës administrativ për tu përgjigje në ankesë sipas nenit 29 të LKA-së do të mund ti drejtohej gjykatës kompetente, por vonesa nuk qëndron dhe kjo nënkuptohet me vet faktin e nxjerrjes së vendimeve nga organet vendimmarrëse të paditurës dhe pranimit të vendimit nga paditësi, konsideron se zhvillimi i procedurës është bërë pa asnjë pengesë, e ligjshme dhe plotësisht në përputhje me LPPA-në.
9. Ka shtuar se, për programin e studimit Studime të Sigurisë, BA 180 ECTS, Kolegji ISPE ka paraparë katër persona në vijim për bartës të këtij programi B.I., A.M., O.S., R.D., dhe A.M.1.. Ky program i ka 180 ECTS kredi dhe rrjedhimisht sipas nenit 26 pika 5.3.4 e UA për Akreditimi, për këtë program Kolegji ISPE duhet të ketë të paktën 3 anëtare të stafit akademik me gradën akademike PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha

e programit të studimit. Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Kolegji ISPE, për këtë program të studimit, B.I., O.S., R.D., dhe A.M.1., ka rezultuar se: B.I., O.S., A.M.1., nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara për të qenë bartës në këtë program të studimit Studime të Sigurisë, BA, 180 ECTS. Kolegji ISPE ka paraqitur si bartës të programit Studimet e Sigurisë BA 180 ECTS pesë persona: B.I., A.M., O.S., R.D., dhe A.M.1.. Kolegji ISPE ka realizuar takim me KSHC-në më datë 07.02.2020, ku palës i është dhënë mundësia që të plotësoj dokumentacionin për stafin të cilin e ka paraqitur si bartës të programeve me orar të plotë, ku B.I. ishte deklaruar si staf i rregullt me orar të plotë në dy institucione të arsimit të lartë, për çka sipas UA 15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, respektivisht neni 30 par.2, i njëjti është larguar nga lista e bartësve të programit, ku dëshmohet edhe përmes platformës së e-akreditimit. O.S., i kishte munguar leje qëndrimi në Kosovë, si shtetase e huaj, e për të cilën Kolegji ISPE nuk kishte dorëzuar dokumentet plotësuese që dëshmojnë të kundërtën, për çka, sipas UA 15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, respektivisht neni 30, paragrafin 5, e njëjta është larguar nga lista e bartësve të programit, A.M.1., i kishte munguar deklarata nën betim për vitin akademik 2019/2020. Me konkretisht, A.M.1., deri me datën 31 tetor 2019, ka vendosur deklaratën nën betim, po e cila ka qenë e nënshkruar me datë 16.04.2018, për çka sipas UA 15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, respektivisht neni 30, paragrafin 1, i njëjti është larguar nga lista e bartësve të programit.

10. Tutje, Kolegji ISPE me datën 16.03.2020 i është drejtuar AKA-se me Shkresën nr. Ref. 370/201-1, ku ka shënuar "Ju lutem bashkangjitur kësaj kërkesë shihni dokumentacionin respektiv për stafin e deklaruar nga ana e kolegjit ISPE për programin BA Studime të Sigurisë: A.M.1., të bashkangjitur aplikimin për zgjatjen e Leje qëndrimit, por për shkak të situatës së fundit të krijuar si pasoje e përhapjes së virusit infektiv Covid 19 pavarësisht konfirmimit nga ana e MPB-së se Leje qëndrimi është gati në pamundësi tërheqjes fizike si pasoje e kufizimit të lëvizjes për disa zona momentalisht nuk është tërhequr. Në rastin e parë që krijohen mundësitë do të tërhiqet vendimi dhe do ta sjellim në AKA. Komisioni i Ankesave ka konstatuar se kjo shkresë ka qenë si rezultat nga takimi i Kolegjit SPE me KSHC që është mbajtur me datën 07.02.2020, ku palës i është dhënë mundësia nga KSHC që të plotëson dokumentacionin për stafin, përfshirë edhe deklaratën nën betim të nënshkruar nga prof. A.M.1., ndërsa pala ankuese tani paditës në shkresën nr. ref, 370/20H, të datës 16.03.2020 nuk e ka dërguar Deklaratën nën betim të profesorit A.M.1., por vetëm

aplikimin për zgjatjen e Leje qëndrimit dhe arsyetimin lidhur me këtë aplikim. KSHC ka mbajtur takim më datë 01.04.2020, ku ka shqyrtuar dosjen e Kolegjit ISPE e të cilës i ka munguar Deklarata nën betim e A.M.1., andaj ka vendosur se i njëjti nuk llogaritet staf i rregullt për të qenë bartës i programit dhe bazuar në faktet e prezantuara dhe dispozitat ligjore KSHC ka vendosur që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit dhe bazuar në nenin 26 pika 5.3.4 e UA për Akreditim të refuzoj aprovimin e aplikacionit për programin e Studimit Studime të Sigurisë BA 180 ECTS. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si e pa bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit dhe të mbetet në fuqi vendimi i KSHC-së Nr.Ref. 576/20D i datës 22.06.2020 dhe vendimi i Komisionit të Ankesave në AKA KA.Nr. 2909/20 i datës 23.11.2020.

### Provat e administruara

11. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendimi i KSHC Nr.Ref:576/20D të datës 22.06.2020, Ankesë i këtij vendimi nga kolegji ISPE me datë 24.07.2020, Vendim i Komisionit të ankesave të AKA-së me nr.KA.nr.2909/20 me datë 23.11.2020, Lista e emrave të propozuar të stafit akademik për Programin Studimet e Sigurisë, Njoftim përmes njoftimit elektronik me e-mail nga AKA për kolegjin ISPE me datë 20.01.2020, Procesverbal i takimit mes përfaqësuesve të kolegjit ISPE dhe bordit të AKA-së me datë 07.02.2020, Kërkese për dokumentacion shtesë për AKA me datë 16.03.2020, Deklaratë për vitin 2017-18 me datë 09.12.2017, Deklaratë nga A.M. me datë 12.09.2017, Vendim nga MASHT me nr.61006 datë 21.12.2015 për Z.A.M. për njohjen e gradës dr.Jur, Kontratë e punësimit mes ISPE dhe A.M. me datë 03.12.2012, Deklaratë për vitin 2017-18 nga R.D., Deklaratë për vitin 2017-18 nga R.D. me datë 03.02.2018, Vendim i MASHT i datës 29.05.2018 për R.D., Diplome doktrate për R.D. nga Universiteti Europian i Tiranës, Diplome Master niveli II për R.D. nga Universiteti Europian i Tiranës, Diplome fakulteti për R.D. nga Universiteti Europian i Tiranës, Përgjigje nga drejtoria e përgjithshme e tatimeve MFE-Republika e Shqipërisë, Kontratë pune e lidhur me ISPE dhe punëdhënësit R.D. me datë 03.02.2018, Deklaratat nën betim nga A.M.1. me datë 16.04.2018, Deklaratat nën betim nga A.M.1. me datë 10.02.2020, Kontratë pune për A.M.1., Vendim i KSHCA-së me nr. 458/12 i datës 09.07.2012, Njoftim mbi vendimin me nr.296 me datë 13.07.2011, Vendim për ri akreditim me nr.559/14 datë 04.07.2014, Vendim për ri akreditim me nr.641/16 datë 15.07.2016, Vendim për tërheqje të akreditimit me nr.808 me datë

03.08.2018 me cilën tërhiqet akreditimi i programeve të studimit të kolegjit ISPE, si në pikën I dhe hiqet masa e pezullimit për programin studime të sigurisë BA,180 ETC, Kërkesë për verifikim të bartësve të programit sipas komunikimeve të datës 12 dhe 16.04.2020, Procesverbal i takimit të datës 14.04.2020, Raporti financiar i përgatitur nga ISPE me të cilën pretendohet demisi i shkaktuar. Nga provat e administruara gjykata konstatoj këtë gjendje faktike:

12. Agjencia e Kosovës për Akreditim me Vendim KSHC Nr.Ref:576/20D të datës 22.06.2020, e ka refuzuar Kërkesën e Kolegjit “ISPE” (nr. 561/19H, datë 31.10.2019) për akreditim në programin BA Studime të Sigurisë Nr. Ref 576/20D të datës 22.06.2020. Në këtë vendim konstaton se Kolegji ISPE për programin Studime të Sigurisë, BA, 180 ECTS, ka paraparë stafin akademik: B.I., A.M., O.S., R.D. dhe A.M.1.. Pas verifikimit u konstatua që tre nga pesë bartësit e programit të prezentuar nuk i plotësojnë kushtet sipas Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), sipas nenit 26, pika 5.3.4, ku përcaktohet, që për këtë program të studimit 180 ECTS Kolegji “ISPE” duhet të ketë të paktën 3 staf akademik me gradën shkencore PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit. Sipas vlerësimit të AKK-së, KSHC, nga shqyrtimi i dosjeve ka rezultuar se: B.I. ishte deklaruar si staf i rregullt me orar të plote në dy institucione të arsimit të lartë, e për çka, sipas Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, respektivisht nenit 30, paragrafin 2, nuk i plotëson kushtet. O.S. i mungon leje qëndrimi në Kosovë. A.M.1. i mungon deklarata nën betim për vitin akademik 2019/2020.
13. Ndaj këtij vendimi paditësi Kolegji ISPE ka parashtruar Ankesë me datë 24.07.2020, me pretendim se nuk janë shqyrtuar faktet ashtu siç janë paraqitur nga ankuesi. Ka deklaruar se si rezultat i vonësve të trajtimit të aplikacionit të Kolegjit ISPE nga ana e AKA/KSHC njëri nga katër anëtarët e stafit të deklaruar nga Kolegji ISPE B.I., ishte deklaruar në ndërkohë për një institucion tjetër, kjo e deklaruar nga anëtarët e KSHC në takimin e mbajtur me qëllim të dhënies së afatit tjetër për IAL-të, për kompletimin e dosjeve për stafin e deklaruar, ku ishte vendosur që KSHC/AKA do të krijonin qasje në sistemin E-Akreditimi në mënyrë që Kolegji ISPE të bënte ndryshime e nevojshme në listën e stafit në ndërkohë. Në ankesë ankuesi pretendon se stafi i mbetur ishte i mjaftueshëm sipas nenit 26 pika 5.3.4 të UA 15/2018 të datës 28.09.2018 me dosje të kompletuar A.M., R.D., A.M.1.. Ka deklaruar se i ka bashkangjitur Deklaratën nën Betim të A.M.1. para



datës 31.10.2019 dhe Deklarata e ri-dërguar me datë 10.02.2020, që është dërguar pas dhënjes së mundësisë për dërgimin e dokumenteve plotësuese.

14. Komisioni i Ankesave i KSHC-së, të AKA, me Vendim Nr.Ref:576/20D të datës 22.06.2020, e refuzon si e pabazuar ankesën e Kolegjit ISPE dhe e vërteton Vendimin e KSHC-së, Nr.Ref:576/20D të datës 22.06.2020, me arsyetim se Komisioni i ankesave ka shqyrtuar pretendimet e palës dhe nga shqyrtimi i dosjeve, ka konstatuar Kolegji ISPE për programin Studime të Sigurisë, BA, 180 ECTS, ka paraqitur si bartës të programit ka propozuar: B.I., A.M., O.S., R.D. dhe A.M.1.. Komisioni ka konstatuar se B.I. ishte i deklaruar si staf i rregullt me orar të plote në dy institucione të arsimit të lartë, e për çka, sipas Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, respektivisht nenit 30, paragrafin 2, i njëjti është larguar nga lista e bartësve të programit. Kjo dëshmohet edhe përmes platformës së e-akreditimit. O.S. i kishte munguar leje qëndrimi në Kosovë, si shtetase e huaj, e për të cilën Kolegji ISPE nuk kishte dorëzuar dokumentet plotësuese që dëshmojnë të kundërtën.
15. Sa i përket Deklaratës nën Betim nga A.M.1. theksuar se kishte të njëjtit i kishte munguar deklarata nën betim për vitin akademik 2019/2020. I njëjti deri me datën 31 tetor 2019, ka dorëzuar deklaratën nën betim, po e cila ka qenë e nënshkruar me datë 16.04.2018. A.M.1., ka sqaruar se pala me shkresën e datës 16.03.2020 nuk e ka dërguar Deklaratën nën betim të profesorit A.M.1., po vetëm aplikimin për zgjatje të leje qëndrimit, dhe arsyetimin lidhur me këtë aplikim. KSHC ka mbajtur takim me datë 01.04.2020, ndërsa pas takimit ku është vendosur për mos akreditim, (13 ditë pas mbajtjes) me datë 13.04.2020 është dorëzuar Deklarata nën Betim nga A.M.1., përmes email-it nga L.G. tek AKA, e cila nuk është pranuar si e bazuar me arsyetim se Kolegji ISPE me datën 16.03.2020 i është drejtuar AKA-se me Shkresën nr. Ref. 370/201-1, ku ka shënuar *"Ju lutem bashkangjitur kësaj kërkesë shihni dokumentacionin respektiv për stafin e deklaruar nga ana e kolegjit ISPE për programin BA Studime të Sigurisë: A.M.1., të bashkangjitur aplikimin për zgjatjen e Leje qëndrimit, por për shkak të situatës së fundit të krijuar si pasoje e përhapjes së virusit infektiv Covid 19 pavarësisht konfirmimit nga ana e MPB-së se Leje qëndrimi është gati në pamundësi tërheqjes fizike si pasoje e kufizimit të lëvizjes për disa zona momentalisht nuk është tërhequr. Në rastin e parë që krijohen mundësitë do të tërhiqet vendimi dhe do ta sjellim në AKA.*

16. Komisioni i Ankesave ka konstatuar në takimin e Kolegjit SPE me KSHC që është mbajtur me datën 07.02.2020, palës i është dhënë mundësia nga KSHC që të plotëson dokumentacion për stafin, përfshirë edhe deklaratën në betim të nënshkruar nga prof. A.M.1., ndërsa pala ankuese në shkresën nr. ref, 370/20H, të datës 16.03.2020 nuk e ka dërguar Deklaratën nën betim të profesorit A.M.1., por vetëm aplikimin për zgjatjen e Leje qëndrimit dhe arsyetimin lidhur me këtë aplikim. KSHC ka mbajtur takim më datë 01.04.2020, ku ka shqyrtuar dosjen e Kolegjit ISPE e të cilës i ka munguar Deklarata nën betim të A.M.1., andaj ka vendosur se i njëjti nuk llogaritet staf i rregullt për të qenë bartës i programit dhe bazuar në faktet e prezantuara dhe dispozitat ligjore KSHC ka vendosur që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit dhe bazuar në nenin 26 pika 5.3.4 e UA për Akreditim të refuzoj aprovimin e aplikacionit për programin e Studimit Studime të Sigurisë BA 180 ECTS.
17. Nga Lista e emrave të propozuar të stafit akademik për programin studimet e sigurisë, figurojnë: B.I., A.M., O.S., R.D. dhe A.M.1..
18. Përmes njoftim me e-mail të datës 05.02.2020, nga AKA të dërguar kolegjit ISPE me datë 07.02.2020, ka ftuar IAL në takim për përmirësim të dokumentacionit për përmbushje të kriterëve.
19. Përmes njoftim me e-mail të datës 20.01.2020, nga AKA të dërguar kolegjit ISPE është njoftuar paditësi se Komisioni në takimin e 79-të të mbajtur me datë 16 dhe 17 Janar, ka trajtuar aplikacionet e reja. Stafi nuk duhet të bëjë asnjë lëvizje brenda çfarëdo programi.
20. Nga Procesverbal i takimit mes përfaqësuesve të kolegjit ISPE dhe bordit të AKA-së konstatohet se me datë 07.02.2020 është mbajtur takim për të diskutuar gjetjet e vlerësimit të aplikacionit.
21. Nga Kërkese për dokumentacion shtesë për AKA me datë 16.03.2020, nga Kolegji ISPE drejtuar AKA-se theksohet: *Ju lutem bashkangjitur kësaj kërkesë shihni dokumentacionin respektiv për stafin e deklaruar nga ana e kolegjit ISPE për programin BA Studime të Sigurisë: A.M.1., të bashkangjitur aplikimin për zgjatjen e Leje qëndrimit, por për shkak të situatës së fundit të krijuar si pasoje e përhapjes së virusit infektiv Covid 19 pavarësisht konfirmimit nga ana e MPB-së se Leje qëndrimi është gati në pamundësi*

*tërheqjes fizike si pasoje e kufizimit të lëvizjes për disa zona momentalisht nuk është tërhequr. Në rastin e parë që krijohen mundësitë do të tërhiqet vendimi dhe do ta sjellim ne AKA. Gjykata konstaton se nga provat e bashkangjitura kërkesës janë: Dokumentacioni i A.M.t, Dokumentacioni i R.D., Dokumentacioni i ndërsa për A.M. të cilit i është bashkangjitur Deklarata nën Betim e datës 16.01.2018 dhe Deklarata nën Betim e datës 10.02.2020.*

22. Me Kërkese për verifikim të bartësve të programit sipas komunikimeve të datës 12.04.2020, Kolegji ISPE ka deklaruar se sa i përket Prof. A.M.1., ka theksuar se të njëjtit i është vazhduar leja e qëndrimit por për shkak të situatës faktike i njëjti nuk mund të jetë prezent në procedura tjera. Prandaj ka kërkuar nga AKA që ta rishikoj pse i njëjti nuk figuron në listë sepse është deklaruar në sistemin e E-akreditimit. Me datë 16.04.2020 AKA, është përgjigjur se sipas marrëveshjes së 7 shkurtit, të gjitha dokumentet e dorëzuara janë dorëzuar KSHC në takim me datë 01.04.2020. Theksohet se Deklarata nën Betim e profesorit M., është dorëzuar me datë 14.04.2020, dokumentet e dorëzuara pas afatit do ti prezentohen KSHC-së në takimin e radhës mirëpo vendimmarrja i takon KSHC-së.
23. Në përgjigje të datës 16.04.2020, përfaqësuesi i Kolegjit ISPE ka theksuar se sipas takimit të datës 7 shkurt, me datë 16.03.2020 i kanë dorëzuar dokumentacionin plotësues por pasi që nuk kanë pranuar asnjë përgjigje pozitive apo negative kanë konsideruar se dokumentacioni është plotësuar, po ka deklaruar se Deklaratën e kanë poseduar me kohë, dhe e njëjta konsiderohet si derivat i kontratës. Megjithatë në takim janë fokusuar në lejet e qëndrimit të bartësve. Konsideron, se programi BA Studime të Sigurisë i plotëson kushtet për aprovim.
24. Në procesverbal të datës 14 Prill 2020, në faqen pesë (5), A.K., njofton se në dosje të profesorit A.M.1. shkruan që i mungon leje qëndrimi, ID dhe Deklaratë nën Betim aty thuhet se ju (Kolegji Iliria ) në takim me Bordin janë njoftua për dokumentet që mungojnë dhe qysh janë sjellë dokumentet tjera është dashur të silltet edhe deklarata. Lidhur me këtë pike, përfaqësuesi i Kolegji Iliria, ka deklaruar se nuk e kanë verifikuar gjendjen sepse nuk kanë pasur qasje në E-Akreditim, por se i gjitha takimi është i incizuar. Më tutje thekson se “...krejt kjo çka ka ndodhë është fjala për një dokument teknik sepse profesori e ka kontratën e viti 2019/20, e ka leje qëndrimin, deklarata është dokument suplementar

i kontratës, nuk është dashtë Bordi ta merr si kritike këtë çështje. Për këtë Drejtori i AKA-së ka deklaruar se dokumentacioni do të dërgojnë në Bord në mbledhjen e ardhshme.

25. Nga vendimnet e bashkangjitura padisë: Vendim i KSHCA-së me nr. 458/12 i datës 09.07.2012, Njoftim mbi vendimin me nr.296 me datë 13.07.2011, Vendim për riakreditim me nr.559/14 datë 04.07.2014, Vendim për riakreditim me nr.641/16 datë 15.07.2016, Vendim për tërheqje të akreditimit me nr.808 me datë 03.08.2018 me cilën tërhiqet akreditimi i programeve të studimit të kolegjit ISPE, si në pikën I dhe hiqet masa e pezullimit për programin studime të sigurisë BA,180ETC.
26. Nga Raporti financiar i përgatitur nga ISPE pretendohet dem i shkaktuar në total 1,173,000.00 € (një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre mijë euro).

### Baza Ligjore

27. Ligji Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, neni 7, *Agjencia e Kosovës për Akreditim AKA është agjenci e pavarur përgjegjëse për vlerësimin dhe promovimin e cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë. Përmes proceseve profesionale dhe transparente të vlerësimit dhe kontrollit të cilësisë apo mjeteve të tjera që konsiderohen të përshtatshme nga ajo, të cilat i plotësojnë praktikatat më të mira ndërkombëtare, AKA-ja siguron që standardet dhe cilësia e arsimit të lartë në Kosovë të plotësojë kërkesat dhe pritjet e Rrjetit Evropian të Asociacionit për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. (ENQA)'' Neni 15 përcakton Akreditimi dhe vlerësimi i cilësisë, 1.Të gjithë bartësit e licencuar të arsimit të lartë u nënshtrohen procedurave të kontrollit dhe vlerësimit të cilësisë nga AKA-ja në përputhje me këtë ligj dhe me aktet nënligjore: paragrafi 6 parasheh se "Nëse një bartës i licencuar i arsimit të lartë nuk arrin të fitojë akreditimin apo riakreditimin institucional, kjo do të rezultojë me një organizim tjetër të akreditimit jo më vonë se pas një viti. 7. Nëse dështon për herë të dytë në marrjen e akreditimit, atëherë i hiqet licenca. Kundër heqjes së licencës, bartësi mund të ankohet në organin kompetent konform Ligjit për Procedurën Administrative dhe Ligjit të Konfliktit Administrativ."*
28. Udhëzimi Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Nr.15/2018, Neni 3 përcakton Kompetencat e Agjencisë së Kosovës për Akreditim,

paragrafi 1 përcakton se: “Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), është agjenci e pavarur dhe misioni i saj kryesorë është vlerësimi dhe akreditimi i institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit, paragrafi 2 parasheh se AKA është përgjegjëse për procesin e akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë. AKA iu përmbahet udhëzimeve dhe standardeve evropiane për cilësi në arsimin e lartë,

29. Neni 5 UA përcakton Akreditimin paragrafi 1 parasheh se “Akreditimi është njohje formale se një institucion i arsimit të lartë dhe apo programet e tij të studimit i plotësojnë standardet ndërkombëtarisht të pranuar të cilësisë. , paragrafi 4 parasheh se procedurat për akreditim të një IAL-së në Kosovë dhe standardet për sigurimin e cilësisë janë në pajtueshmëri me Ligin për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës dhe me Udhëzimet Administrative ku paragrafi 5 parasheh se Akreditimi bëhet në nivel 5.1 Institucionit të Arsimit të Lartë, 5.2, Programit të studimit, 5.3, Programit dhe institucionit të studimit.
30. Neni 10 i UA përcakton procedurën e akreditimit, ndërsa para.1 pika 1.2 thekson se: Aprovimi i listave të stafit akademik. 1.2.1. Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) do të beje aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuara në formë elektronike së bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës mbledhjen e ardhshme të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga Institucioni i Arsimit të Lartë, përgatitet nga stafi i AKA-së.
31. Neni 11 paragrafi 1 citon se: Agjencia e Kosovës për Akreditim ka kohë një vit për trajtimin e aplikacioneve prej datës së pranimit të kërkesës për akreditim, paragrafi 2 përcakton se “ Aplikacionet për akreditim, duhet të dorëzohen në AKA më së largu deri më 31 Tetor, në mënyrë që atyre të ju garantohet akreditimi për vitin e ardhshëm akademik.
32. Neni 26 pika 5.3.4 përcakton se “ Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë që për do grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredit të

programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1), staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimeve.

33. Neni 30 par.1 përcakton dorëzimin e deklaratat e stafit akademik të angazhuar: për IAL-të ti dorëzojnë, jo më larg se data 31 Tetor, paragrafi 2 parasheh se stafi akademik i cili e ndryshon angazhimin brenda vitit akademik, nuk do të pranohet nga AKA për qëllime të vlerësimit dhe akreditimit, ndërsa paragrafi 7 përcakton se “Deklarata e rreme sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 392, do të procedohet zyrtarisht pranë organeve kompetente” .

### Vlerësimi i gjykatës

34. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenin 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, përgjigjen e të paditurës në padi, deklaratimet e tyre në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.
35. Gjykata shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit kontestues lidhur me kompetencën e organit administrativ në kuptim të nenit 4 të LPPA, i cili përcakton kufizimin e organeve publike që veprimtarinë tyre ta realizojnë brenda kompetencave të tyre. Në par. 1 të këtij nenit është përcaktuar *Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca*” dhe në përputhje me Nenin 7 dhe Nenin 18 të Ligji Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, të cituar më lartë, vlerëson se Vendimi i kundërshtuar të Vendimit Nr. Ref. 576/20D i datës 22.06.2020, i të paditurës Agjencia e Kosovës për Akreditim-Këshilli Shtetëror i Cilësisë dhe Vendimi Nr. KA.NR. 2909/20 i datës 23.11.2020, i Komisionit të Ankesave të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, është nxjerrë brenda kompetencave ligjore si institucion kompetent për verifikimin e cilësisë së arsimit dhe akreditimin e bartësve të licencuar të arsimit të lartë.
36. Gjykata konstaton se megjithëse vendimi i kundërshtuar është nxjerrë brenda kompetencave ligjore të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, ky vendim përbën shkelje

të parimeve të procedurës administrative për shkak të vonesave në përpilimin e vendimit, dhe atë Nenit 98 të LPPA-së ku përcaktohet afati për përfundimin e procedurës administrative paragrafi 1, *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj*, sepse Agjencia e Kosovës për Akreditim kërkesën e paditësit për akreditim e ka trajtuar në mbledhjen e 80-të të datës 01.04.2010, lista është publikuar në web faqen zyrtare të Agjencisë me datë 10.04.2020, ndërsa vendimin Agjencia e Kosovës për Akreditim Këshilli Shtetërorë i cilësisë e ka marrë me datë 22.06.2024, e që është në kundërshtim me nenin 98 të LPA-së.

37. Është e qartë që Udhëzimi Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (UA nr. 15/2018) në Neni 11, paragrafi 1, parasheh që *Agjencia e Kosovës për Akreditim ka kohë një vit për trajtimin e aplikacioneve prej datës së pranimit të kërkesës për akreditim, por gjykata vlerëson se afati një vit për trajtimin e aplikacioneve nuk nënkupton se e paditura ka në dispozicion periudhën prej një viti për hartimin e aktit administrativ pasi ka përfunduar trajtimin e aplikacionit. Gjykata konstaton se edhe Vendimi Nr. KA.NR. 2909/20 i datës 23.11.2020, i Komisionit të Ankesave të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, me të cilin është refuzuar ankesa e Kolegjit ISPE e datës 24.07.2020, me letër përcjellëse të datës 08.09.2020 është marrë në kundërshtim me nenit 22 të UA nr. 15/2018 i cili përcakton se: i cili përcakton se: “1. Komisioni i Ankesave, do të trajtoj dhe do të vendos për ankesat e parashtruara nga institucionet e arsimit të lartë kundër vendimeve të KSHC-së. ... 3. Komisioni i ankesave shqyrton ankesën dhe nxjerr vendim brenda tridhjetë (30 ditësh nga data e dorëzimit të ankesës. I cili vendim është përfundimtar dhe pala e pakënaqur mund të filloj konfliktin administrativ përmes padisë në gjykatën kompetente. ...” Prandaj, në të dy rastet gjykata konstaton shkelje të dispozitave që kanë të bëjnë me afatin nga e paditura AKA. Megjithatë, konform 52 të LPPA-së, tejkalimi i afatit për nxjerrjen e aktin nuk është arsye e vetme për ta konsideruar të njëjtin si të kundërligjshëm, kjo sepse për vonesë apo mosveprimin të organit administrativ pala ka në dispozicion mjetet juridike të parapara për shkak të heshtjes administrative.*

38. Prandaj, gjykata konstaton se përveç, shkeljes se afateve, akti administrativ është në përputhje me formën e aktit administrativ (sipas Nenit 46 të LPPA-së), dhe strukturën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar (Nenit 47 të LPPA-së) dhe vendosi ta vlerësoj gjendjen faktike të konstatuar në vendim.
39. Gjkata vlerëson se paditësi në ankesë tek e paditura të datës 24.07.2020 nuk i ka kundërshtuar konstatimet në Vendimin KSHC Nr.Ref:576/20D të datës 22.06.2020 të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, që tre nga bartësit e programit të propozuar nuk i plotësojnë kushtet sipas Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), sipas nenit 26, pika 5.3.4, ku përcaktohet, që për këtë program të studimit 180 ECTS Kolegji “ISPE” duhet të ketë të paktën 3 staf akademik me gradën shkencore PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit. E që sipas vlerësimit të AKK-së, KSHC, nga shqyrtimi i dosjeve kishte rezultuar se: B.I. ishte i deklaruar si staf i rregullt me orar të plote në dy institucione të arsimit të lartë, e për çka, sipas Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, respektivisht nenit 30, paragrafin 2, nuk i plotëson kushtet. O.S. i mungon leje qëndrimi në Kosovë. A.M.1. i mungon deklarata nën betim për vitin akademik 2019/2020.
40. Prandaj, Gjkata vlerëson se ankuesi nuk kishte kontestuar të gjeturat për anëtarin tjetër të stafit akademik të propozuar O.S. për të cilën ishte konstatuar se i mungon leje qëndrimi në Kosovë. Mirëpo kishte deklaruar se stafi i mbetur ishte i mjaftueshëm sipas nenit 26 pika 5.3.4 të UA 15/2018 të datës 28.09.2018 me arsyetim se Kolegji ISPE kishte dosje të kompletuar me stafin akademik: A.M., R.D., A.M.1., duke pretenduar se e kishte bashkangjitur Deklaratën nën Betim të A.M.1. para datës 31.10.2019 dhe Deklarata e ridërguar me datë 10.02.2020, që është dërguar pas dhënies së mundësisë për dërgimin e dokumenteve plotësuese. E sa i përket stafit akademik B.I., pretendon se si rezultat i vonësive të trajtimit të aplikacionit të Kolegjit ISPE nga ana e AKA/KSHC njëri nga katër anëtarët e stafit të deklaruar nga Kolegji ISPE B.I., ishte deklaruar në ndërkohë për një institucion tjetër.
41. Në raport me Deklaratën nën Betim nga A.M.1., nga provat e administruara e të elaboruara më lartë gjykata vlerësoj në listën e emrave të propozuar të stafit akademik për programin studimet e sigurisë, ishin propozuar B.I., A.M., O.S., R.D. dhe A.M.1..



Me email të datës 05.02.2020, AKA e kishte ftuar kolegjin ISPE me datë 07.02.2020 për përmirësim të dokumentacionit për përmbushje të kriterëve. Ndërsa paditës me datë 16.03.2020, për dosjen e akreditimit në programin BA Studime të Sigurisë për A.M.1., kishte bashkangjitur vetëm aplikimin për zgjatjen e Leje qëndrimit.

42. Nga provat e administruara gjykata vlerësoj se Deklarata nën Betim nga A.M.1. e përditësuar është dorëzuar tek e paditura me datë 14.04.2020, përmes email-it nga L.G. tek AKA, 13 ditë pasi KSHC në takim me datë 01.04.2020, ka marrë vendim për mosakreditim, si dhe pas publikimit të listës për mos akreditimit në web faqën e AKA-së. Pas kësaj me datë 10.04.2020, Kolegji IPSE i është drejtuar AKA-së me Kërkese për verifikim të bartësve të programit sipas komunikimeve të datës 12.04.2020, në të cilën kishte kërkuar AKA që ta rishikoj pse Prof. A.M.1., nuk figuron në listë sepse i njëjti është deklaruar në sistemin e E-akreditimit.
43. AKA, me datë 16.04.2020 i është përgjigjur paditësit se të gjitha dokumentet e dorëzuara janë dorëzuar KSHC në takim me datë 01.04.2020, ndërsa dokumentet e dorëzuara pas afatit ku theksohet Deklarata nën Betim e profesorit M. e dorëzuar me datë 14.04.2020, do të prezentohen KSHC-së në takimin e radhës dhe vendimmarrja i takon KSHC-së.
44. Gjykata vlerëson se edhe nga përgjigja e paditësi datës 16.04.2020, konfirmohet se dokumentacioni për Prof. A.M.1. nuk ishte dorëzuar i kompletuar, sepse përfaqësuesi i Kolegjit ISPE se me datë 16.03.2020 kanë dorëzuar dokumentacionin plotësues, por pasi që nuk kanë pranuar asnjë përgjigje pozitive apo negative kanë konsideruar se dokumentacioni është plotësuar, por pretendon se Deklarata konsiderohet si derivat i kontratës dhe konsideron se programi BA Studime të Sigurisë i plotëson kushtet për aprovim. Nga kjo rezulton se Deklarata nën Betim e datës 10.02.2020 nuk ishte dorëzuar siç pretendon paditësi me datë 16.03.2020. Ky fakt konfirmohet edhe sipas procesverbalit të datës 14 Prill 2020, në faqen pesë (5), A.K., njofton se *në dosje të profesorit A.M.1. shkruan që i mungon leje qëndrimi, ID dhe Deklaratë nën Betim aty thuhet se ju (Kolegji Iliria) në takim me Bordin janë njoftua për dokumentet që mungojnë dhe qysh janë sjellë dokumentet tjera është dashur të sillet edhe deklarata.* Ndërsa lidhur me këtë pike, përfaqësuesi i Kolegji Iliria, ka deklaruar *se nuk e kanë verifikuar gjendjen sepse nuk kanë pasur qasje në E-Akreditim, por se i gjitha takimi është i incizuar.* Më tutje thekson se *“...krejt kjo çka ka ndodhë është fjala për një dokument teknik sepse profesori e ka*

*kontratën e viti 2019/20, e ka leje qëndrimin, deklarata është dokument suplementar i kontratës, nuk është dashtë Bordi ta merr si kritike këtë çështje. Për këtë Drejtori i AKA-së ka deklaruar se dokumentacioni do të dërgojnë në Bord në mbledhjen e ardhshme.*

45. Gjykata vlerëson se Neni 30 të par.7 përcakton detyrimin e Deklarimit të stafit Akademik për IAL-të ku theksohet *se IAL duhet të dorëzojnë deklaratat e stafit akademik të angazhuar, jo më larg se data 31 Tetor*, ku parashihet edhe Deklarimi sipas paragrafi 7 “*Deklarata e rreme sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 392, do të procedohet zyrtarisht pranë organeve kompetente*”. Prandaj Gjykata vlerëson se Deklarata nën Betim është përveç se kërkesë formale kusht për kompletim të dokumentacionit të Deklarimit të stafit akademik. Po ashtu gjykata vlerëson se paditësi, Kolegji ISPE e kishte të njohur këtë fakt, në aplikacionit për akreditim për vitin akademik 2019/2020, për prof. A.M.1. ka dorëzuar deklaratën nën betim të datës 16.04.2018.
46. Propozimi i përfaqësuesit të paditësit për ta kërkuar procesverbalin e takimit të KSHC-se kur është vendosur lidhur me akreditimin e programit të Kolegjit ISPE në mënyrë që të konstatohet *se shkelja ka qene nga drejtori i AKA-së, lidhur me dorëzimin e dosjes se plote të A.M. apo ka qenë shkelje e KSHC mos kualifikimi i A.M. si bartës i programit*, gjykata e vlerëson të panevojshme sepse nga provat e administruara e të elaboruara më lart u vërtetua në mënyrë të bazuar se dosja e stafit të propozuar profesor A. M. nga Kolegji ISPE ishte e pakompletuar nga paditës me të gjitha dokumentet e kërkuara, përkundër që të njëjtit i është dhënë mundësia e korrigjimit të aplikacionit, respektivisht përditësimit me ç ‘rast “Kolegji ISPE” datën 16.03.2020 me Shkresën nr. Ref. 370/201-1, ka dorëzuar dokumentacionin për stafin e deklaruar nga ana e kolegjit ISPE për programin BA Studime të Sigurisë, dhe për të njëjtin A.M.1., kishte dorëzuar vetëm aplikimin për zgjatjen e Leje qëndrimit. Prandaj nga provat e administruara u vërtetua se dokumenti respektivisht Deklarata nën Betim e profesorit A.M.1. e nënshkruar me date 10.02.2020, nuk përben shkelje ligjore as drejtoi i AKA-se dhe as nga KSHC kur është vlerësuar se është dorëzuar pas afatit kur ishte bërë vlerësimi i aplikacioneve nga dosja e Kolegjit ISPE nga KSHC në takim më datë 01.04.2020, ndërsa Komisioni i Ankesave të KSHC kishte vlerësuar se Deklarata nën Betim e profesorit A.M.1. e nënshkruar me date 10.02.2020, ishte dorëzuar pas takimit ku është vendosur për mos akreditim, me datë 13.04.2020, me Vendim Nr.Ref:576/20D të datës 22.06.2020, e ka refuzuar si e pa bazuar me arsyetim se palës i është dhënë mundësia nga KSHC që të

plotëson dokumentacion për stafin, përfshire edhe deklaratën në betim te nënshkruar nga prof. A.M.1., ndërsa pala ankuese tani paditës në shkresën nr. ref. 370/20H, te datës 16.03.2020 nuk e ka dërguar Deklaratën nën betim te profesorit A.M.1..

47. Pretendimet e përfaqësuesit të paditësit se si rezultat i vonesave të trajtimit të aplikacionit të Kolegjit ISPE nga ana e AKA/KSHC njëri nga katër anëtarët e stafit të deklaruar nga Kolegji ISPE B.I., ishte deklaruar në ndërkohë për një institucion tjetër, janë të pabazuara sepse gjykata nuk ka konstatuar vonesa në trajtimin e aplikacionit të Kolegjit ISPE, sipas Nenit 11 paragrafi 1, të UA nr. 15/2018, *Agjencia e Kosovës për Akreditim ka kohë një vit për trajtimin e aplikacioneve prej datës së pranimit të kërkesës për akreditim*, përkundër që vonesat janë shkaktuar në marrjen e vendimit të shkallës së parë dhe të dytë, gjykata konstaton se e paditura AKA vendim marrjen e ka bazuar në gjendjen faktike të konstatuar në mbledhjen e 80-të të datës 01.04.2010. Çështja e deklaramit të B.I. si staf i deklaruar nga Kolegji ISPE e i cili ishte deklaruar për një institucion tjetër, nuk është detyrim i AKA-se që të ndikoj në vullnetin e lirë të stafit se për cilin institucion të deklarohen, për më tepër kjo është çështje për të cilën vet institucioni dhe stafi i deklaruar duhet të dakordohen. Për më tepër gjykata vlerëson se deklarata e paditësit lidhur me profesorin B.I. janë kundërthënëse, sepse njëherë paditësi deklaroi se si rezultat i vonesave të trajtimit të aplikacionit të Kolegjit ISPE nga ana e AKA/KSHC njëri nga katër anëtarët e stafit të deklaruar nga Kolegji ISPE B.I. ishte deklaruar për një institucion tjetër, e pastaj deklaroi se AKA ishte pajtuar që Kolegjit ISPE ti krijonte qasje në E-Akreditim dhe ta largonin emrin e Z. I. nga lista edhe pse një qasje e tillë nuk ishte lejuar. Ndërsa, në provat e bashkangjitura padisë paditësi nuk e ka bashkangjitur asnjë provë për profesorin B.I., siç janë bashkangjitur Dokumentacioni i A.M.t, Dokumentacioni i R.D., Dokumentacioni i ndërsa për A.M.. I njëjti përkundër që i ka në dispozicion provat sepse pretendon se e ka dorëzuar dosjen e kompletuar, kërkon nga gjykata të siguroj nga e paditura. Sipas Neni 7, paragrafi 7.1 i Ligji nr. 03/1-006 për Procedurën Kontestimore *palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*. Gjukata vlerëson së palët mund të propozojnë që gjykata të merr vetëm provat që nuk janë në dispozicion të palës që i propozon.
48. Gjukata vlerëson se Vendim i KSHCA-së me nr. 458/12 i datës 09.07.2012, Njoftim mbi vendimin me nr.296 me datë 13.07.2011, Vendim për riakreditim me nr.559/14 datë

04.07.2014, Vendim për ri akreditim me nr.641/16 datë 15.07.2016, Vendim për tërheqje të akreditimit me nr.808 me datë 03.08.2018 me cilën tërhiqet akreditimi i programeve të studimit të kolegjit ISPE, si në pikën I dhe hiqet masa e pezullimit për programin studime të sigurisë BA,180ETC, nuk janë relevant për vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar, sepse nuk kanë të bëjnë me periudhën e akreditimit 2018/19 për të cilën është marrë vendimi i kundërshtuar.

49. Gjykata vlerëson se Letër Rekomandimi i Avokatit të Popullit të cilës paditësi i referohet si prove trajton kërkesën e ankuesit me nr. 522/2018 prandaj përfaqësuesi i paditësit nuk e ka sqaruar ndërlidhjen me procesin e akreditimit për vitin 2019/20.
50. Prandaj, gjykata vlerëson se Komisioni i Ankesave i KSHC-së, të AKA, me Vendim Nr.Ref:576/20D të datës 22.06.2020, me të cilën është refuzuar si e pabazuar ankesa e Kolegjit ISPE, dhe është vërtetuar Vendimi i KSHC-së, Nr.Ref:576/20D të datës 22.06.2020, me arsyetim se nga shqyrtimi i dosjeve, ka konstatuar Kolegji ISPE për programin Studime të Sigurisë, BA, 180 ECTS, ka paraqitur si bartës të programit 5 persona: B.I., A.M., O.S., R.D. dhe A.M.1., është vërtetuar drejtë gjendja faktike kur Komisioni ka konstatuar se B.I. ishte i deklaruar si staf i rregullt me orar të plote në dy institucione të arsimit të lartë, e për çka, sipas Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, respektivisht nenit 30, paragrafin 2, i njëjti është larguar nga lista e bartësve të programit. O.S. i kishte munguar leje qëndrimi në Kosovë, si shtetase e huaj, e për të cilën Kolegji ISPE nuk kishte dorëzuar dokumentet plotësuese që dëshmojnë të kundërtën dhe A.M.1. i kishte munguar deklarata nën betim për vitin akademik 2019/2020, sepse deklarata nën betim e dorëzuar me datën 31 tetor 2019, ka qenë e nënshkruar me datë 16.04.2018.
51. Prandaj nga provat e administruara nuk është vërtetuar gjendje tjetër faktike nga ajo që i padituri ka vlerësuar në procedurën administrative, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Vendimi për shpenzimet procedurale u bazua në nenin 63 të LKA-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.338/22, datë 21.05.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimin të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.